



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 25
Prishtinë, më 4 dhjetor 2013, në orën 10:00, salla S-II
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCEVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, , Afrim Hoti dhe Albert Kinolli.

Munguan: Imri Ahmeti, Bali Muharremaj, Valbona Dibra dhe Adem Grabovci,

I ftuar: Lars Lage Olofsson, auditor i përgjithshëm.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri, koordinatore e Komisionit, Mehmet Simnica zyrtar i fushës në Komision.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 25.11.2013;
3. Shqyrtimi i Projektbuxhetit për vitin 2014-2016, për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm;
4. Shqyrtimi para miratimit në parim i Projektligjit nr. 04/4744/L-236/1 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 25.11.2013;

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi njëzëri, pa vërejtje, procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 25 nëntor 2013.

3. Shqyrtimi i Projektbuxhetit për vitin 2014-2016, për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm;

Kryetari - Theksoi se KMFP-ja, në takimin përgatitor ka shqyrtuar kërkesën buxhetore të ZAP-it për vitin 2014 si dhe vlerësimet për vitet 2015 dhe 2016. Komisioni ka konstatuar se buxheti i ZAP-it për vitin 2014, është me 1 ulët për 46.200 euro. Mirëpo, nëse krahasohet buxheti i vitit 2014, i aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me KASH-in për vitet 2014-2016, është një zbritje e shpenzimeve prej 55.000 euro.

Lars Lage Olofsson, auditor i përgjithshëm – ZAP-i është relativisht një institucion i ri dhe puna që ne po bëjmë është ndër politikat që po kërkon Bashkimi Evropian. Ne kemi projektin me Bankën Botërore që do të zgjatë për dy vite. Po ashtu po mundohemi të vëmë në zbatim një institucion të auditimit që e kryen punën e vetë sipas standardeve ndërkombëtare të auditimit. Për vitin 2014, ne po krijojmë një sistem për të mundur të kryejmë më shumë auditime, të kryejmë certifikimin e auditorëve në numër me të madh, si dhe auditimet të jenë më efikase. Sipas kësaj, objektivat janë shumë të qarta. Ne nuk po investojmë në gjëra të mëdha. Ne ende jemi në objekt ku paguajmë qira. Kemi kërkuar të kemi një pjesë të objektit të ish- OSBE-së, për tu vendosur, por kjo nuk ka ndodhur. Projekt-Ligji për ZAP-in nuk është i përfshirë në koston buxhetore për vitin 2014. Në vitin 2015-2016 do të ketë kosto me të lartë, ngase për dy persona tani pagat e tyre paguhen nga donacionet. Po ashtu, ne mendojmë të realizojmë të hyra vetjake përmes auditimeve që do të bëhen për sektorin privat. Këto të hyra shkojnë në thesar të MF-së. Shuma e mjeteve që ishte në buxhetin e vitit 2013, në kategorinë e subvencioneve, ishte rezervë për implementimin e ligjit të ri. Kjo shumë e mjeteve është shkurtuar nga Ministria e Financave, me arsyetimin se këto mjetet do ti ketë ZAP-i në dispozicion në momentin e miratimit të Projektligjit në Kuvend. Buxheti për ZAP-in nuk lë hapësirë për rritje të pagave apo diçka të ngjashme. Kjo mjafton vetëm për t'i mbuluar nevojat elementare të funksionimit të këtij institucioni.

Kryetari-Nëse krahasohet buxheti i vitit 2014 me buxhetin e vitit 2013, vërehet se ka zbritje të buxhetit në shumën prej 46 mijë euro. Po ashtu kosto e implementimit të Ligjit nuk është e përfshirë në buxhetin e vitit 2014. Për vitin 2014 nuk ka planifikim për kategorinë e subvencioneve dhe transferove, shumë kjo që ekzistonte në vitin 2013. Ministria e Financave si duket nuk ka bërë vlerësim real të koston financiare për projektligjin.

Ramiz Lladrovci – Qeveria i ka miratuar kërkesën buxhetore të ZAP-it ashtu siç është kërkuar. Prandaj nuk mund të themi që Qeveria nuk e ka ndarë buxhetin e kërkuar nga ZAP-i dhe janë pajtuar lidhur me këtë. Kërkesa ka qenë 2 milion e 74 mijë e 253 euro dhe Ministria e Financave ka ndarë buxhetin prej 2 milion e 74 mijë e 253 euro. Do të thotë se buxheti i kërkuar nga ZAP-i është miratuar ndërsa 51mijë euro janë kosto shtesë e Ligjit.

Sa i përket vendeve të reja të punës, me këtë kosto ka paraparë 37 mijë e 300 euro për paga dhe mëditje mjete shtesë. Auditori nuk është përgjegjës se pse nuk është përfshirë kostoja e ligjit, por besoj që Ministria e Financave me kohë do ta inkorporoj këtë kosto.

Lars Lage Olofsson, auditor i përgjithshëm – Ministria e Financave ka bërë vlerësimin e koston së ligjit të ri. Është diku rreth 56 mijë euro, nëse fillon në janar 2014 dhe për 2015, është dy herë me shumë. Së bashku me ligjin ka pozita të zëvendësauditorit dhe asistent të auditorëve, ku me ligj pagat e tyre janë përcaktuar në lidhje me pagën kushtetuese. Ajo çka e bënë një nevojë më të madhe në këtë zyrë, vjen nga ligjet e tjera, sepse nëse na vjen për të bërë

kërkesa për auditim të rregullsisë së RTK-së apo Agjencisë së Inteligjencës, kjo ka kosto të re. Jemi dakorduar me ndarjen buxhetore që na është bërë. E vetmja gjë që themi këtu është që kostoja e ligjit nuk është përfshirë. Paratë për ligj duhet të merren diku tjetër. Kostot për ligjin janë paraparë për periudhën 2014-2016 dhe kjo nuk është përfshirë as në KASH e as në projektbuxhet. Kostoja do të jetë 50 mijë euro për çdo vit. Pra, kostoja e ligjit ka të bëjë me koston e menaxhmentit, ndërsa kostot e tjera janë paraparë me ligje të tjera.

Kryetari – Zgjidhja për këtë duhet kërkuar përmes KBF-së dhe rekomandimi i Komisionit të jetë për përkrahje për kosto shtesë për ligjin.

Kryesuesi konstatoi se, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri ka vendosur që Komisionit për Buxhet dhe Financa t'i

REKOMANDOJË

Në buxhetin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, të ndahen mjete shtesë për implementimin e Projektligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit Nr. 04/L – 236.

Kryesuesi konstatoi se, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri ka vendosur që Kuvendit t'i

REKOMANDOJË

- 1. Të miratohet në parim, Projektligji Nr. 04/L-236 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.**
- 2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet, deputeti Ali Sadriu, kryetar i Komisionit.**

Kryesuesi konstatoi se, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

Përfundim

- 3. Formohet grupi i punës, i cili do të merret me amendamentimin e Projektligjit nr. 04/L-236 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit në këtë përbërje: Ramiz Lladrovci, raportues, Murselj Haljilji,-anëtar dhe Afrim Hoti, anëtar.*
- 4. Grupi i punës autorizohet që në emër të Komisionit të ndërmarrë të gjitha veprimet për amendamentimin e këtij projektligji dhe në vazhdimësi e njofton Komisionin për veprimet e ndërmarra lidhur me amendamentimin e këtij projektligji.*
- 5. Raporti përfundimtar me propozim-amendamentet, e grupit të punës, i procedohet Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike për shqyrtim dhe miratim, i cili njëherësh edhe e procedon atë në mbledhje plenare.*

Mbledhja përfundoi në orën 11:25.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu